



2



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIZRENU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRIZREN

Nr.21786/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN me gjykatesin Sefer Gutaj, dhe procesmbajtësen Besarie Kryeziu, në procedurën kundërvajtëse kunder te pandehures, Seylan Mazrek, nga Mamusha, për shkak të kundërvajtjes nga neni, 3 i Ligjit nr. 03/L-151, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, në baze nenit 195 dhe nenit 198 al. 1 pika 8 dhe 10, të Ligjit mbi kundërvajtjet me datën 28.12.2011, merr

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehures, Seylan Mazrek, nga Mamusha, kryesuse e Asambles se Kuvendit komunal te Mamushes, për shkak të kundërvajtjes nga neni, 3 i Ligjit nr. 03/L-151, per Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave te Zyrtareve të Lartë Publik, sepse parqitesi i kerkesës ka hequr dorë nga kërkesa dhe se gjate degjimit të të panadehurës dhe provave qe ka sjellur, është vertetuar se e pandehura nuk ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vëhet në barrë, në bazë të nenit 198 al. 1 pika 8 dhe 10, të Ligjit mbi kundërvajtjet.

- Shpenzimet e procedurës kundërvajtëse bien në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.
- në kuptim te nenit 110 al. 2 të ligjit mbi kundërvajtjet.

A r s y e t i m

Me kerkesen e Agjencionit Kundër Korrupsionit, me nr.01-3199/11, te dt.14.07.2011, eshte zhvilluar procedura kundërvajtëse, kundër të pandehurës, Seylan Mazrek, nga Mamusha, kryesuse e Asambles së Kuvendit Komunal te Mamushes, për shkak të kundërvajtjes nga neni, 3 i Ligjit nr. 03/L-151, per Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratavete te Zyrtareve te Lartë Publik.

Gjykata per dt.16.12.2011, kishte ftuar te pandehurën qe te deklarohet rreth kundervjtjes e cila i vehej ne barre dhe te njejtën e ka degjur po me dt. 16.12.2011, e cila ka theksuar se nuk ka kryer nje kundervajtje te tille, pasi formularin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe Dhuratave te Zyrtarëve te Lartë Publik, e ka paraqitur me koh, poashtu, ne ndërkoh, Paraqitesi i Kerkesës, Agjencioni Kunder Korrupsionit, ka terhequr kerkesën, kunder te pandehuës, Seylan Mazrek, nga Mamusha, kryesuse e Asambles se Kuvendit komunal te Mamushes, për shkak të kundërvajtjes nga neni, 3 i Ligjit nr. 03/L-151, per Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe Dhuratave te Zyrtarëve te Latrë Publik,

./.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>D-P</u>	Bi Prot. <u>03-139/2012</u>
Nr. f. pag.	Dnia
Broj stranica <u>01</u>	Dati <u>17-01-2012</u>
Nr. pagus	
PRISHINE	

Andaj, në bazë të cekurave me lartë, e duke u bazuar në nenin 198 al.1 pika 8 dhe 10, të Ligjit mbi Kundërvajtjet, procedura kundërvajtëse kundër, të pandehurës, Seylan Mazrek, nga Mamusha, kryesuse e Asambles se Kuvendit komunal të Mamushes, për shkak të kundërvajtjes nga neni, 3 i Ligjit nr. 03/L-151, per Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe Dhuratave te Zyrtarëve te Lartë Publik, është PEZULLUAR.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marr në baze te nenit 110.al.2, te Ligjit mbi kundërvajtjet . •

Me sa u cek me larte, u vendos sikur ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE PRIZREN

Nr.12786/2011

dt. 28.12.2011

Procesmbajtesja
Besarie Kryeziu

Gjykatësi,
Sefer Gutaj

UDHEZIMI JURIDIK; Kundër këtij aktvendimi parashtruesi i kërkesës dhe i pandehuri në afat prej 8 ditësh nga dorëzimi mundë të ushtrojnë ankesë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë. Ankesa dërgohet nëpërmjet kësaj gjykate pa taksa.